



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:221810
Datë: 28.01.2025
Numri i dokumentit: 06766120

Ac.nr.2001/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fatmir Baloku-Kryetar i kolegjit, Naime Ahmeti dhe Frosina Sylejmani-anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses K.S “S.U.G.A”, me seli në Prishtinë, rruga “P.V”, pa nr. të cilën e përfaqëson me autorizim K.P, jurist nga Prishtina, kundër të paditurit G.I, nga Prishtina, rruga “E.H”, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit R.I, me bazë juridike rimbursim dëmi, me vlerë të kontestit 2.100 €, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga i padituri, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, C.nr.815/18, i datës 18.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.01.2025, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit G.I nga Prishtina, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil C.nr.815/18, i datës 18.10.2022, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm Divizioni civil C.nr.815/18, i datës 18.10.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.815/18, i datës 18.10.2022, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses K.S “S.U.G.A”, me seli në Prishtinë, rruga “P.V”, pa nr. ashtu që DETYROHET i padituri G.I, nga Prishtina, rruga “E.H”, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit, për aksidentin e datës 01.02.2015, t’ia paguaj shumën prej 2.100 €.II. DETYROHET i padituri që paditëses, shumën e gjykuar sikurse në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi t’ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data 08.03.2018 (data e paraqitjes së padisë në gjykatë), si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 170 €, e të gjitha këto ti përmbush në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka parashtruar i padituri përmes të autorizuarit, për shkak të shkëlqes të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta prishë aktgjykimin dhe lëndën t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ,aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, 195 dhe 200 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e të paditurit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka ushtruar padi kundër të paditurit për rimbursim borgji me datën 08.03.2018 si pasojë e aksidentit të datës 01.02.2015.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka vendosur që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar, duke vendosur më detalisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Ndërsa në arsyetim mes tjerash ka theksuar: Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se në këtë çështje juridike kontestimore kërkesëpadija e paditëses është e bazuar andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga provat e administruara gjykata ka konstatuar se me datën 01.02.2015, në ora 00:20 minuta, në rrugën “V.F”, në Prishtinë, i padituri ka shkaktuar aksident trafikës me automjetin e tij të markës “M”, tipit “...”, me targa të regjistrimit Deri të kjo gjendje faktike gjykata ka ardhur duke u mbështetur në këto prova të cilat i ka pranuar si të besueshme dhe atë: Raporti Policor i Aksidentit me numër ..., i datës 01.02.2015, si dhe Ekspertizën e Komunikacionit e punuar nga eksperti B.L, e datës 15.07.2022. Sipas ekspertizës së komunikacionit e punuar nga eksperti B.L, e datës 15.07.2022, si dhe sqarimeve plotësuese të dhëna në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 28.09.2022, rezulton se deri të aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të shoferit të automjetit “A”, (M.,) me targa ..., me veprimet e tij, ndërrimi i shiritit në mënyrë të pasigurte dhe kthimi gjysmërrethor i palejuar. Gjykata ekspertizën e komunikacionit e ka vlerësuar si profesionale dhe argumentuar mirë prandaj të njëjtën e ka pranuar në tërësi si të besueshme për rastin konkret. Me ujdinë jashtëgjyqësore me numër 0146/15, të datës 02.03.2015, të lidhura në mes të K.S “S.U.G.A”, me seli në Prishtinë dhe “N.T.SH M.S.M”, gjykata konstaton se palët me ujdë rregullojnë të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me rastin e kompensimit të dëmit, të pësuar në aksidentin e datës 01.02.2015, përgjegjës për të cilin sipas ekspertizës së komunikacionit është tani i padituri G.I, me automjetin e markës “M”, tipit “...”, me targa të regjistrimit Nga urdhër pagesa – transferi bankar nga Raiffeisen BANK, e datës 23.03.2015, paditësja ka kryer pagesën për të dëmtuarin “N.T.SH M.S.M”, për demin material, detyrimin sipas ujdisë jashtëgjyqësore numër 0146/15, të datës 02.03.2015. Baza juridike e kërkesë padisë, që i padituri të jetë përgjegjëse për rimbursimin e dëmit paditëses gjejnë mbështetje në dispozitat e Ligjit Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësi me nr. 04/L -018, e lidhur me dispozitat e nenit 245 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Paditësja është dashur ta kompensoj dëmin të dëmtuarit për aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 10.08.2015, në bazë të dispozitës së nenit 14 par. 1 nën par. 1.2 e lidhur me par. 3 të Ligjit Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësisë me nr. 04/L -018, në të cilën shprehimisht parashihet se “Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese”. Meqenëse paditësja në bazë të provave në shkresat të lëndës e ka përmbushur detyrimin ndaj të dëmtuarit si pasojë e këtij aksidenti ka të drejtë që të kërkojë rimbursimin e shumes së paguar në bazë të nenit 14 të Ligjit Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësi me nr. 04/L -018, e cila shprehimisht parasheh se, i siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimave të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimimit, ndërsa siguruesi pas përmbushjes së detyrimit ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, andaj gjykata gjeti se në rastin konkret pala e paditur është përgjegjës për ta përmbushur detyrimin ndaj palës paditëse si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata po ashtu ka vlerësuar të gjitha provat dhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në

zgjidhjen e çështjes ndryshe përtej asaj që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 par. 1 dhe 2 të LMD-ës, ku është paraparë se Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor edhe kamatën, lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit. Ndërsa si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurit për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën e ushtrimit të padisë në gjykatë, datë 13.03.2018. Vendimin që pala e paditur ti bart shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke mare parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të procedurës dhe atë për ekspertizë të komunikacionit shumë prej 150 € dhe taksë gjyqësore për padi shumë prej 20 €. Andaj duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e konsideron të drejtë dhe të ligjshëm, i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e as me shkelje të tjera të pretenduara nga i padituri, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, si dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se nga ekzaminimi i aktgjykimit të ankimuar, rrjedh se gjykata e shkallës së parë, me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka vlerësuar drejtë provat dhe përmes nxjerrjes së provave, drejtë ka vërtetuar faktet që kanë rezultuar në vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe i njëjti aktgjykim përmban të gjitha arsyet vendimtare sipas nenit 160 par.4 dhe 5, dhe të njëjtat arsye të dhëna janë në harmoni të plotë lidhur me vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimeve ankimore të të paditurit , për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sipas Gjykatës së Apelit një pretendim i tillë i të paditurit rezulton i pa bazuar, sepse gjykata e shkallës së parë, gjatë procedurës së zhvilluar lidhur me këtë çështje kontestimore, ka administruar provat dhe ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike me prova bindëse, përfshirë këtu edhe ekspertizën nga lëmia e komunikacionit.

Sa i përket pretendimeve ankimore për parashkrim të borxhit, Gjykata e Apelit gjeti se i padituri as me përgjigje në padi e as gjatë seancave në gjykatën e shkallës së parë nuk është thirrur në institutin e parashkrimit, prandaj në kuptim të dispozitave të nenit 180.3 të LPK-së ku parashihet se prapësimi i parashkrimit dhe prapësimi me qëllim kompensimi që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten në ankesë. Prandaj nisur nga kjo dispozitë ligjore Gjykata e Apelit nuk e shqyrtoj pretendimin ankimor të paditurit lidhur me parashkrimin e borxhit.

Gjykata e Apelit shqyrtoj edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin relevante për vendosje ndryshe në këtë çështje kontestimore.

Nga arsyet e cekura si më lartë, Gjykata e Apelit në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par.1 pika (d), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2001/2023, me datë 28.01.2025.

Numri i lëndës: 2019:221810
Datë: 28.01.2025
Numri i dokumentit: 06766120

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v